



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1289

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Ekologjia” SH.P.K, si dhe ankesës së OE “Mburoya” SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Komunës së Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontrate Kornize 2 vjeçare” me numër të prokurimit 622-25-1796-2-2-1, me 03/02/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohen**, si pjesërisht të bazuara ankesat e OE “Ekologjia” SH.P.K, me nr. 2025/1289 e datës 30/12/2025, si dhe ankesa e OE “Mburoya” SH.P.K me nr. 2025/1289 e datës 31/12/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontrate Kornize 2 vjeçare” me numër të prokurimit 622-25-1796-2-2-1.

2. **Mbetët në fuqi** vendimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit si në pikën I të dispozitivit.

3 **Lejohet** kthimi i tarifave të ankesave në shumat e deponuara ashtu që obligohen operatorët ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtrajnë kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komunës së Prizrenit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 12.03.2025 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontrate Kornize 2 vjeçare” me numër të prokurimit 622-25-1796-2-2-1. 2. B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara është publikuar me datën 27.10.2025.

AK, Komuna e Prizrenit me datën 15.12.2025 ka publikuar njoftimin B 58 për anulim të kontratës.

Me datën 19.12.2025 operatorët ekonomik OE “Ekologjia” SH.P.K si dhe OE “Mburoya” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të kontratës. Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i datës 22.12.2025.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 30.12.2025 OE “Ekologjia” SH.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/1289 (Nr. protokolli) si dhe OE “Mburoya” SH.P.K ankesën nr. 2025/1292 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 2025/1289 dhe ankesa nr. 2025/1292 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Përgjigje e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim të OE ankues “Ekologjia” SH.P.K

Operatori Ekonomik “Ekologjia” SH.P. K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontrate Kornize 2 vjeçare” me nr të Prok: 622-25-1796-2-2-1.

Autoriteti Kontraktues, me datën 22. 12. 2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa juaj për rishqyrtim të refuzohet si e pa bazuar për arsyet në vijim:

Ju mungojnë: 1. Licensa për veprimtarin sipas rregullores së OBSH-së (shih DT), 2. Kopja e Akreditimit të organizatës e cila i ka lëshuar certifikatat e OE-së. Gjithashtu ju keni ndërhyrë në paramasat e AK së gjë që është në kundërshtim me nenin 17.2, 17.7 dhe 32.8 të rregullores për prokurim publik.

Përgjigje e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim të OE ankues “Mburoya” SH.P.K

Operatori ekonomik “Mburoya” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontrate Kornize 2 vjeçare”. me nr të prok: 622-25-1796-2-2-1 Autoriteti Kontraktues, me dat. 22. 12. 2025 , ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka vendosë që kërkesa juaj për rishqyrtim të refuzohet si e pa bazuar për arsyet në vijim:

Ju mungojnë: 1. Licensa për veprimtarin sipas rregullores së OBSH-së (shih DT), 2. Autorizimi për importin e preparateve sipas DT. 3. Kopja e Akreditimit të organizatës e cila i ka lëshuar certifikatat e OE-së. 10. Vendimi i menaxherit të projektit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Mburoya” SH.P.K ne ankesën Nr. 1292/2025 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi I: Në vendimin e AK-së për eliminim thuhet: Ju mungon: Licensa për veprimtarin sipas rregullores së OBSH-së. Kërkesa e Dosjës së tenderit ka qenë: Argumentet tona: Dosja e Tenderit ka kërkuar: “Origjinalin e lejes valide të lëshuar nga autoriteti relevant për kryerjen e punëve profesionale të DDD.” OE “Mbyroua” SHPK ka dorëzuar: - Lejen për kryerjen e punëve profesionale për Dezinsektim, Dezinsektim dhe Deratizim, të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me nr. REF: 04.58-442/25, datë 23.10.2025. Ky dokument gjendet në ofertën e dorëzuar: - Faili: “Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale – 1 MB (PDF)” - Faqe: 10–11. Licenca është dokument zyrtar, valide dhe autoritative, dhe përmbush plotësisht kërkesën e DT-së. Pretendimi i AK-së është faktikisht i pasaktë dhe juridikisht i pambështetur, në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së, i cili obligon AK-në të konsiderojë një tender të përgjegjshëm kur ai përputhet me kërkesat e DT-së.

Pretendimi II: Në vendimin e AK-së për eliminim thuhet: Ju mungon: Autorizimi për importin e preparateve sipas DT. Kërkesa e Dosjes së tenderit ka qenë: Pra Dosja e Tenderit ka kërkuar: “OE duhet të posedojë autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar për preparate DDD. MBUROYA SH.P.K ka dorëzuar autorizim valid: - I lëshuar nga ORMA srl - Adresa: Via A. Chiribiri 10028 Trofarello (TO), Itali - Autorizimi është lëshuar në emër të MBUROYA SHPK Dokumenti gjendet në ofertë: Faili: “Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale – 1 MB (PDF)” - Faqe: 29 Prandaj, edhe ky pretendim është i pavërtetë, ndërsa eliminimi në këtë bazë përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së, pasi OE është trajtuar në mënyrë jo të barabartë dhe jo transparente. Poashtu në ofertën tonë gjendet edhe Leja e Importit.

Pretendimi III: Në vendimin e AK-së për eliminim thuhet: Ju mungon: Kopja e Akreditimit të organizatës e cila i ka lëshuar certifikatat e OE-së. Kërkesa e AK-së ka qenë: MBUROYA SH.P.K ka dorëzuar në ofertë: - ACCREDITATION CERTIFICATE Nr. 1099-5 - Organ akreditues për trupin certifikues RIGCERT - Trupi certifikues që ka lëshuar certifikatat ISO për

OE. Dokumenti gjendet në ofertë: - Faili: “Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale – 1 MB (PDF)” - Faqe: 17–28. Ky fakt dëshmon qartë se AK-ja nuk ka ekzaminuar dokumentacionin në tërësi, në kundërshtim të plotë me nenin 59 paragrafi 1 dhe 4 të LPP-së.

Pretendimi IV: Në vendimin e AK-së për eliminim thuhet: Mungon Vendimi i menaxherit të projektit. Kërkesa e DT-së ka qenë: Dosja e Tenderit ka kërkuar:- Një pasqyrë tabelare të personelit; - Emrin, mbiemrin, profesionin, eksperiencën dhe pozicionin; - Personel të angazhuar me kontrata ose parakontrata. OE ka përmbushur këtë kërkesë duke: - Dorëzuar listën e plotë të stafit (min. 15 punëtorë); - Caktuar Menaxher të Kontratës / Projektit: z. Pajtim Bytyqi – Ekolog, me 6 vite përvojë profesionale, në pozitën e menaxherit në kompani. Dokumenti gjendet në ofertë: - Faili: “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – MB 2” - Faqe: 1DT-ja nuk ka kërkuar vendim të veçantë formal, por vetëm dëshmi për staf dhe pozicion, të cilat janë dorëzuar. Interpretimi shtesë i AK-së përbën shkelje të nenit 7 paragrafi 6 pika (v) të LPP-së. Provë: faqja e parë e stafit.

Pretendimi V ankimor: V.1-AK-ja nuk ka trajtuar në mënyrë të barabarabart të gjithë operatorët ekonomik, për shkak se me datë **18.12.2025**, në ora **10:30**, OE **MBUROYA SHPK** ka ushtruar të drejtën e qasjes në dokumentet zyrtare të aktivitetit të prokurimit. Pas analizimit të dokumentacionit të operatorit tjetër ekonomik pjesëmarrës, janë konstatuar **mungesa substanciale dhe shkelje serioze të Dosjes së Tenderit**, të cilat, megjithatë, janë toleruar nga Autoriteti Kontraktues, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me **nenin 7 dhe 59 të LPP-së**.

Pretendimi V.2: Dosja e Tenderit ka kërkuar që operatori ekonomik: - të jetë i certifikuar sipas ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 për shërbimet DDD; - certifikatat të posedojnë QR code ose link për verifikim; - të dorëzohet kopja e akreditimit të organizatës certifikuese. Nga dokumentacioni i GROE: Doctor Exterminator dhe Ekologjia SHPK rezulton se:- certifikatat ISO nuk përmbajnë QR code ose link për verifikim;- mungon kopja e akreditimit të organizatës që ka lëshuar certifikatat ISO. Këto mungesa përbëjnë mospërmbushje të drejtpërdrejtë të kërkesave eliminatore, të cilat, sipas praktikës së prokurimit publik, do të duhej të rezultonin në diskualifikim.

Pretendimi V.3: Sipas kërkesës 9.1 & 9.2 të DT-së, OE duhej të dorëzonte: - pasqyrë tabelare të personelit (min. 15 punëtorë); - emrin, mbiemrin, profesionin, eksperiencën dhe pozicionin; - dokumentin origjinal, të nënshkruar dhe të vulosur.

Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit tjetër rezulton se: - dokumentacioni i stafit nuk është në përputhje me kërkesat formale dhe përmbajtësore; - mungojnë dëshmi të plota për angazhim sipas kushteve të DT-së.

Pretendimi V.4: Dosja e Tenderit ka kërkuar që OE të posedojë raport të vlerësimit të riskut të kompanisë, të lëshuar nga: - institucionet përkatëse, ose - kompani e licencuar për vlerësim të riskut. Nga dokumentacioni i operatorit tjetër mungon nga Licena e kompanisë për vlerësimin e rriskut, duke mos përmbushur kërkesën e DT-së 3, pika b.

Pretendimi V.5: Sipas treguesve minimalë të DT-së, OE duhej të posedonte pajisje specifike, ndër të tjera:

- ULV aerosol elektrik me dy rezervuar (6.5 L & 20 L) dhe zorrë 5 m për dezinfektim; - 5 pajisje për pastrimin e ajrit që largojnë grimcat PM2.5 dhe PM10 dhe viruset. Nga dokumentacioni i operatorit tjetër rezulton se: - mungon pajisja ULV me dy rezervuar; - mungojnë pajisjet për

pastrimin e ajrit.

Pretendimi V.6: DT-ja ka kërkuar: - metodologji të detajuar të shërbimeve DDD; - plan dinamik të ndarë në faza për 25 ditë pune; - deklarata origjinale, të nënshkruara dhe të vulosura për planin dinamik dhe garancinë e shërbimit.

Nga oferta e operatorit tjetër rezulton se:

- mungojnë deklaratat origjinale të planit dinamik 25-ditor;
- dokumentacioni nuk është i plotë dhe nuk përmbush kërkesat eliminatore të kërkesës 5 së dojës tenderike.

Pretendimi V.7: GROE: Doctor Exterminator dhe Ekologjia SHPK, ka bër ndryshime të Paramasës në mënyr të paligjëshme

Gjatë shqyrtimit të Formularit C – Lista e Çmimeve, është konstatuar se operatorët e lartëcekur e kanë ndryshuar sasinë për pozicionin “Dezinsektimi i parkut të qytetit” nga 11 hektarë në 1 hektar. Ky veprim: - përbën modifikim të paligjshëm të formularit standard; - ul artificialisht çmimin e ofertës; - është në kundërshtim me Rregulloren Nr. 001/2022, neni 17.2 dhe 17.7, si dhe nenin 32.8, i cili ndalon çdo ndryshim të përmbajtjes dhe strukturës së Formularit të Dorëzimit të Tenderit. Kjo shkelje përbën devijim material, i cili do të duhej të rezultonte në refuzimin e menjëhershëm të ofertës.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ekologjia” SH.P.K në ankesën 2025/1289 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Nr. 1: Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka përcaktuar kriterin si vijon: “Subjekti biznesor duhet të ketë licencë për këtë lloj aktiviteti dhe të jetë në përputhje me rregulloret e OBSH-së në lidhje me mënyrën dhe kohën e kryerjes së punës.” Ndërsa, si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri, është kërkuar: “Origjinali i lejes valide e lëshuar nga autoriteti relevant për kryerjen e punëve profesionale të DDD.” GOE Ekologjia SHPK & Doctor Exterminator DDD SHPK, në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, ka dorëzuar Lejen e përkohshme valide të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), e cila përbën autoritetin e vetëm kompetent, ligjërisht të autorizuar dhe institucionalisht relevant për lëshimin e lejeve për ushtrimin e veprimtarisë së Dezinsektimit, Dezinfektimit dhe Deratizimit (DDD) në territorin e Republikës së Kosovës.

Autoriteti Kontraktues, megjithatë, ka refuzuar ofertën e ankuesit duke interpretuar gabimisht kriterin, sikur të kërkohej një licencë e veçantë “sipas rregullores së OBSH-së” Dihet se OBSH nuk është autoriteti licencues dhe nuk lëshon licenca operative për operatorë ekonomikë, dhe se kriteri kërkon përputhje me rregulloret e OBSH-së si standard profesional, dhe jo posedim të një licence të veçantë nga një organizatë ndërkombëtare.

Për pasojë, Autoriteti Kontraktues ka aplikuar një interpretim të paqartë dhe të pasaktë të kriterit, duke mos marrë parasysh faktin se ankuesi ka dorëzuar dokumentin e vetëm të vlefshëm dhe të njohur ligjërisht për ushtrimin e veprimtarisë DDD në Republikën e Kosovës. Eliminimi i GOE Ekologjia SHPK & Doctor Exterminator DDD SHPK mbi këtë bazë përbën shkelje të parimit të sigurisë juridike, pasi operatori ekonomik është penalizuar për mungesën e një dokumenti që nuk lëshohet nga asnjë autoritet kompetent.

Pretendimi Nr. 2: Autoriteti Kontraktues ka refuzuar ofertën e GOE me arsyetimin se mungon kopja e akreditimit të organizatës e cila i ka lëshuar certifikatat ISO, pa ndërmarrë asnjë veprim për kërkimin e informatave sqaruese nga ana e operatorit ekonomik.

Ne si GOE kemi dorëzuar certifikatat ISO të kërkuara, ndërsa akreditimi i trupit certifikues është i shënuar qartë në vetë certifikatat, përmes vulës/stampës përkatëse, e cila dëshmon se certifikatat janë lëshuar nga një organizatë e akredituar. Në këtë situatë, nuk kemi të bëjmë me mungesë dokumentesh, por me një çështje formale e cila është lehtësisht e verifikueshme.

Ligji për Prokurimin Publik i jep Autoritetit Kontraktues të drejtën dhe detyrimin për të kërkuar informata sqaruese, në rastet kur dokumentacioni i dorëzuar është i paqartë ose kërkon verifikim shtesë. Kjo mundësi ekziston pikërisht për të shmangur eliminimin e operatorëve ekonomikë për arsye formale, kur kapaciteti profesional dhe teknik është i dëshmuar. Në përputhje me Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, konkretisht Kapitullin 10 – “Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit”, parashihet qartë se në rastet kur mungon licenca ose kur mungon certifikata ISO, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë dhe mundësi të kërkojë informata sqaruese nga operatori ekonomik.

Ky udhëzues bazohet drejtpërdrejt në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, përkatësisht:• nenin 66 të LPP-së, që rregullon sqarimin e dokumenteve administrative; dhe• nenin 69 të LPP-së, që rregullon sqarimin e dokumenteve teknike dhe profesionale. Udhëzuesi e klasifikon qartë mungesën e licencës ose të certifikatave ISO si situata që nuk justifikojnë refuzimin e menjëhershëm të tenderit, por që kërkojnë veprim aktiv të Autoritetit Kontraktues për sqarim, në përputhje edhe me:• nenin 59 të LPP-së, që rregullon shqyrtimin dhe vlerësimin e tenderëve; dhe• nenin 72 të LPP-së, që kërkon administrim të drejtë dhe proporcional të procedurës së prokurimit.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar asnjë informacion sqarues, ndonëse dokumentacioni i dorëzuar nga GOE ishte i verifikueshëm dhe mund të sqarohej lehtësisht. Në vend të kësaj, AK ka aplikuar menjëherë masën më të rëndë procedurale. Ky veprim ka rezultuar në eliminim të pajustificuar të GOE, ndonëse situata mund të ishte sqaruar lehtësisht përmes kërkesës për informata shtesë. Mosshfrytëzimi i këtij mekanizmi ligjor cenon parimin e trajtimit të drejtë dhe të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e procedurës. Për këto arsye, eliminimi i GOE Ekologjia SHPK & Doctor Exterminator DDD SHPK mbi këtë bazë është i pabazuar dhe duhet të anulohet. Ne dokumentetet shtojca po i paraqesim Certifikatat e Akreditimit të cilat AK ka mundur që shumë lehtë ti verifikojë sipas ligjeve në fuqi.

Pretendimi Nr. 3: Autoriteti Kontraktues, në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, për herë të parë ka shtuar pretendimin se GOE Ekologjia SHPK & Doctor Exterminator DDD SHPK ka ndërhyrë në paramasat e përcaktuara nga AK-ja, duke u thirrur në nenet 32.8, 17.2 dhe 17.7 të Rregullores për Prokurimin Publik. Ky pretendim është i pabazuar.

Së pari, pretendimi për ndërhyrje në paramasa nuk ka qenë pjesë e vendimit fillestar të eliminimit, as nuk ka qenë objekt i kërkesës për rishqyrtim. Shtimi i një arsyeje të re refuzuese vetëm në fazën e rishqyrtimit cenon sigurinë juridike dhe të drejtën e GOE-së për t’u njoftuar dhe për t’u mbrojtur ndaj arsyeve të eliminimit.

Së dyti, nenet 32.8, 17.2 dhe 17.7 të Rregullores për Prokurimin Publik, në të cilat thirret Autoriteti Kontraktues, nuk rregullojnë çështjen e paramasave apo mënyrën e ofertimit të çmimeve për njësi matëse, por kanë të bëjnë me strukturën formale të dosjes së tenderit dhe nënshkrimin digjital të Formularit të Dorëzimit të Tenderit. GOE nuk ka ndryshuar përmbajtjen apo strukturën e Formularit të Dorëzimit të Tenderit, dhe për rrjedhojë këto dispozita nuk mund të përdoren si bazë për pretendimin për “ndërrhyrje në paramasa.”

Së treti, lidhur me pozicionin “Dezinsektimi i parkut të qytetit”, në paramasën e përgatitur nga Autoriteti Kontraktues është shënuar sasia 11 ha, ndërkohë që çmimi është paraparë të jepet i peshuar. Sipas parimeve të ofertimit me çmim të peshuar dhe rregullave të prokurimit publik, çmimi jepet për njësi matëse, në këtë rast për 1 hektar (1 ha).

GOE, si operator ekonomik profesionist në fushën e shërbimeve DDD, ka vepruar në përputhje me këto parime, duke paraqitur çmimin për 1 ha, pa ndryshuar njësinë matëse dhe pa ndryshuar shërbimin e paraparë nga Autoriteti Kontraktues.

Ky veprim nuk përbën ndryshim sasie dhe as ndërrhyrje në paramasa, por zbatim korrekt të mënyrës së llogaritjes së çmimit për njësi, me qëllim që oferta të jetë e qartë dhe e krahasueshme. Për këtë arsye, GOE nuk mund të penalizohet për faktin se ka zbatuar saktë rregullat e ofertimit dhe ka korrigjuar një paqartësi teknike që buron nga vetë paramasa.

Si rrjedhojë, pretendimi i Autoritetit Kontraktues për “ndërrhyrje në paramasa” është i papranueshëm, teknikisht i gabuar dhe juridikisht i pabazuar, dhe nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për refuzimin e ofertës së GOE Ekologjia SHPK & Doctor Exterminator DDD SHPK.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1289/2025, i cili është dorëzuar me datë 14.01.2026.

Lidhur me pretendimet e OE “Ekologjia” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1289 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1 Operatori ekonomik ankues tek pretendimi ankimor numër 1 thekson se Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka përcaktuar kriterin si vijon:

Kërkesa: “Subjekti biznesor duhet të ketë licencë për këtë lloj aktiviteti dhe të jetë në përputhje me rregulloret e OBSH-së në lidhje me mënyrën dhe kohën e kryerjes së punës.

Dëshmia: Ndërsa, si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri, është kërkuar: “Origjinali i lejes valide e lëshuar nga autoriteti relevant për kryerjen e punëve profesionale të DDD.

Sipas OE ankues Autoriteti Kontraktues ka aplikuar një interpretim të paqartë dhe të pasaktë të kriterit, duke mos marrë parasysh faktin se ankuesi ka dorëzuar dokumentin e vetëm të vlefshëm

dhe të njohur ligjërisht për ushtrimin e veprimtarisë DDD në Republikën e Kosovës. Eliminimi i GOE Ekologjia SHPK & Doctor Exterminator DDD SHPK mbi këtë bazë përbën shkelje të parimit të sigurisë juridike, pasi operatori ekonomik është penalizuar për mungesën e një dokumenti që nuk lëshohet nga asnjë autoritet kompetent.

Pra nga Letra standarde me arsyetimin e eliminimit konstatojmë se OE ankues është eliminuar si operator i pa përgjegjshme me arsyetimin se ju mungon:

- Licensa për veprimtarin sipas rregullores se OBSH-së
- Kopja e Akreditimit të organizatës e cila i ka lëshuar certifikatat e OE-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues ka dorëzuar përmes ofertës lejen e përkohshme të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, saktësisht departamenti i politikave bujqësore me datë 15.09.2025.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1: Operatori ekonomik ankues tek pretendimi ankimor numër 1 thekson se Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka përcaktuar kriterin si vijon:

Kërkesa: “Subjekti biznesor duhet të ketë licencë për këtë lloj aktiviteti dhe të jetë në përputhje me rregulloret e OBSH-së në lidhje me mënyrën dhe kohën e kryerjes së punës. Dëshmia: Ndërsa, si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri, është kërkuar: “Origjinali i lejes valide e lëshuar nga autoriteti relevant për kryerjen e punëve profesionale të DDD.

Sipas OE ankues Autoriteti Kontraktues ka aplikuar një interpretim të paqartë dhe të pasaktë të kriterit, duke mos marrë parasysh faktin se ankuesi ka dorëzuar dokumentin e vetëm të vlefshëm dhe të njohur ligjërisht për ushtrimin e veprimtarisë DDD në Republikën e Kosovës. Eliminimi i GOE Ekologjia SHPK & Doctor Exterminator DDD SHPK mbi këtë bazë përbën shkelje të parimit të sigurisë juridike, pasi operatori ekonomik është penalizuar për mungesën e një dokumenti që nuk lëshohet nga asnjë autoritet kompetent.

Pra nga Letra standarde me arsyetimin e eliminimit konstatojmë se OE ankues është eliminuar si operator i pa përgjegjshme me arsyetimin se ju mungon:

- Licensa për veprimtarin sipas rregullores se OBSH-së
- Kopja e Akreditimit të organizatës e cila i ka lëshuar certifikatat e OE-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues ka dorëzuar përmes ofertës lejen e përkohshme të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, saktësisht departamenti i politikave bujqësore me datë 15.09.2025.

Nga kjo certifikatë rezulton se Operatorit Ekonomik i lejohet përkohësisht kryerja e punëve profesionale të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit. Nga dokumenti i lëshuar konstatojmë se kemi të bëjmë lëshim të lejes në pajtim me nenin 51, paragrafi 3, nenparagrafi 3.6 i Ligjit Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve.

Sipas kërkesës në dosje të tenderit “Subjekti biznesor duhet të ketë licencë për këtë lloj aktiviteti dhe të jetë në përputhje me rregulloret e OBSH-së në lidhje me mënyrën dhe kohën e kryerjes së punës, në bazë të formulimit të kërkesës rezulton se një licencë e tillë duhet të jetë në harmoni me rregulloret e OBSH që në fakt leja e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë nuk përmend

rregulloret e OBSH-së. Mendojmë që një kërkesë e tillë do të duhej të sqarohej në fazën e sqarimeve të dosjes së tenderit dhe të specifikohet në dosje të tenderit se cili organ e lëshon një licensë të tillë sipas rregulloreve të OBSH-së. Bazuar në sqarimin e mësipërm konstatohet se pretendimi ankimor nr. 1 është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 2: Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit (pretendimit nr 2) që ka të bëjë sipas AK-së me mungesën e Kopjes së Akreditimit të organizatës e cila i ka lëshuar certifikatat e OE-së. Sqarojmë se kërkesa në dosje të tenderit në lidhje me këtë kriter ka qenë si ne vijim:

Kërkesa: 5. Subjekti biznesor duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001-2015, ISO 140001 2015, ISO 45001 2018, për shërbimet DDD

Dëshmia: 5. Kopja e certifikates ISO 9001-2018, ISO 140001 2015, ISO 45001 2018, . Certifikatat duhet të posedojnë qr code ose linkun për verifikim.

Te tri certifikatat e dorëzuara nga GOE ankues posedojnë linkun për verifikim andaj si të tilla plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit.

Tek kërkesa nr 7 në dosje të tenderit autoriteti kontraktues ka kërkuar si dëshmi edhe 7. Kopja e akreditimit të organizatës e cila e ka lëshuar certifikatat për OE.

Një dëshmi e tillë ka mundur të verifikohet edhe përmes linkur të ofruar apo edhe të kërkohej informacione shtesë sipas nenit 72 të LPP-së. Bazuar në sqarimin e mësipërm konstatohet se pretendimi ankimor nr. 2 është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 3: Sqarojmë se pretendimi ankimor nr 3, nuk është pjesë e arsyeve të eliminimit të OE ankues sipas letrës standarde të bashkangjitur me vendimin e AK-së.

Tek paramasa e çmimeve përgatitur nga AK-Kuvendi Komunal i Prizrenit tek pozicioni Deinspektimi i parkut të qytetit ka vendosur sasinë 11 dhe njësinë ha. Sipas nenit 54.15 të LPP-së i cili thotë Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, Autoriteti Kontraktues duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve/artikujve” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët.

Andaj në këtë rast AK-ka përdorur çmimin njësi me peshim mirëpo tek ky pozicion i cekur me lartë është përdoruar sasia indikative që në një paramasë të tillë nuk mund të përdoren në pozicione të caktuara çmime njësi ndërsa në pozicione të caktuara sasi indikative sepse në këto raste nuk mund të kemi çmimi për njësi sipas peshimit dhe po ashtu nuk mund të kemi karahasueshmëri të çmimeve në mes të operatoreve ekonomik, në parim mund të jetë një gabim teknik i lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 dhe 7 të LPP-së pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Bazuar ne përshkrimin e bërë me sipër, pretendimeve ankimore te operatorit ekonomik ankues sqarojmë se AK-Komuna e Prizrenit ka anuar ne tërësi aktivitetin e prokurimit ku tek te tre operatoret ekonomik ofertues kemi te bëjmë nder te tjera me arsyeshmeri te njëjtë te anulimit ku mungon “Licensa për veprimtarin sipas rregullores se OBSH-së” andaj rekomandojmë Panelin Shqyrtues qe ankesa e operatorit ekonomik ankues te aprovohet pjesërisht e bazuar mirëpo te mbetet ne fuqi Vendimi i AK-së i datës 15.12.2025 mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit sepse oferta e operatorit ekonomik ankues nuk është ne harmoni te plotë me paragrafin 4 te nenit 59 te LPP-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues është pajtuar pjesërisht me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës dhe operatori ekonomik nuk është pajtuar me mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pretendimet e OE “Mburoya” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1292 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1Operatori ekonomik ankues tek pretendimi ankimor numër 1 thekson se Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka përcaktuar kriterin si vijon:Kërkesa:Subjekti biznesor duhet të ketë licencë për këtë lloj aktiviteti dhe të jetë në përputhje me rregulloret e OBSH-së në lidhje me mënyrën dhe kohën e kryerjes së punës.Dëshmia:Ndërsa, si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri, është kërkuar: “Origjinali i lejes valide e lëshuar nga autoriteti relevant për kryerjen e punëve profesionale të DDD.Pra nga Letra standarde mbi arsyetimin e eliminimit konstatojm se OE ankues është eliminuar si operator i pa përgjegjshem me arsyetimin se ju mungon:Licensa per veprimtarin sipas rregullores se OBSH-së.Eksperti shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues ka dorëzuar përmes ofertës lejen e përkohshme te lëshuar nga Ministria e Bujqesisë , saktësisht departamenti i politikave bujqësore me datë 23.10.2025, ref: 04.58-442/25.

Data: 23.10.2025

Ref. 04.5-442/25

Drejtori i Departamentit të Politikave Bujqësore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, dt. 21.10.2010), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nenin 5 (paragrafi 5.4. c) të Rregullores 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, në pajtim me nenin 51 paragrafi 3 nenparagrafi 3.6 Ligji Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve të dt. 17.01. 2013 si dhe kërkesës së parashtruar me **MBUROYA SH.P.K** me Nr.3304 të dates **16.10.2025** në bazë të procesverbalit dt **23.10.2025** të Komisionit për Licencim të Departamentit të Politikave Bujqësore, nxjerr këtë:

Për dhënien e lejes së përkohshme

1. I LEJOHET PËRKOHËSISHT operatorit me **MBUROYA SH.P.K** me seli ne Prizren, kryerja e punëve profesionale të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit.
2. Kryerja e punëve profesionale të përcaktuara nga pika 1 e këtij vendimi, lejohet në afat të caktuar nga dt. **23.10.2025 deri me 23.04.2026.**
3. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

Nga kjo certifikatë rezulton se Operatorit Ekonomik i lejohet përkohësisht kryerja e punëve profesionale te Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit. Nga dokumenti i lëshuar konstatohet se kemi të bëjmë lëshim të lejes në pajtim me nenin 51, paragrafi 3, nenparagrafi 3.6 i Ligjit Nr. 04/L-120 për Mbrojtjen e Bimëve.


Sipas kërkesës në dosje të tenderit “Subjekti biznesor duhet të ketë licencë për këtë lloj aktiviteti dhe të jetë në përputhje me rregulloret e OBSH-së në lidhje me mënyrën dhe kohën e kryerjes së punës, në bazë të formulimit të kërkesës rezulton se një licencë e tillë duhet të jetë në harmoni me rregulloret e OBSH që në fakt leja e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë nuk përmend rregulloret e OBSH-së. Mendojmë që një kërkesë e tillë do të duhej të sqarohej në fazën e sqarimeve të dosjes së tenderit dhe të specifikohet në dosje të tenderit se cili organ e lëshon një licensë të tillë sipas rregulloreve të OBSH-së. **Bazuar në sqarimin e mësipërm konstatohet se pretendimi ankimor nr. 1 është pjesërisht i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 2 Sa i përket pretendimit ankimor nr 2 OE ankues është eliminuar nga Autoriteti Kontraktues sepse i mungon : Autorizimi për Importin e preparateve sipas DT.Sqarojmë se kërkesa në dosje të tenderit në lidhje me këtë kriter ka qenë si në vijim:

Kërkesa: 6. Autorizimi i prodhuesit ose dileri i autorizuar i cili duhet të dëshmor se ka autorizim nga prodhuesi për produktet.

Dëshmia:6. OE duhet të posedoj autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar për preparate DDD.

Sqarojm se ne dosje te tenderit te operatorit ekonomik ankues Mburoja shpk ne fajlin me emërtim “ Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale fq 29 gjendet dokumenti si ne vijim:



Autoriteti kontraktues ne letrën standarde mbi tenderuesin e eliminuar nuk ka specifikuar ndonjë arsye se pse ky autorizim nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit. Po ashtu ne ratse te tilla te dyshimeve apo ne mungesë te informatave bindëse AK-ka mundur te veproj sipas nenit 72 te LPP-se dhe te kërkoj sqarimet shtesë si tek Autoriteti Kontraktues apo te institucionet tjera relevante.

Bazuar ne sqarimin e mësipërm konstatojm se pretendimi ankimor nr. 2 është i bazuar. Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 3 Sa i përket pretendimit ankimor nr 3 OE ankues është eliminuar nga Autoriteti Kontraktues sepse i mungon: Kopja e akreditimit te organizatës e cila i ka lëshuar certifikatat e OE-së. Sqarojm se kërkesa ne dosje te tenderit ne lidhje me këtë kriter ka qenë si ne vijim:Kërkesa: 5. Subjekti biznesor duhet të jetë i certifikuar sipas ISO 9001-2015, ISO 140001 2015, ISO 45001 2018, për shërbimet DDD.Dëshmia: 5. Kopja e certifikates ISO 9001-2018, ISO 140001 2015, ISO 45001 2018 . Certifikatat duhet të posedojn qr code ose linkun per verifikim. Tek kërkesa nr 7 ne dosje te tenderit autoriteti

kontraktues ka kërkuar si dëshmi edhe 7. Kopja e akreditimit të organizatës e cila e ka leshuar certifikatat për OE.

Bazuar ne dokumentet e dorëzuara nga OE ankues te cilat gjenden ne fajllin “Kërkesat e përshtatshmërisë” fq 17-28, mendojm qe Autoriteti Kontraktues është dashur te kërkoj sqarimet përkatëse (informacione shitesë) sipas nenit 72 te LPP-së apo nenit 38 te Rregullores per Prokurim Publik. Ne fajll gjendet dokumentet qe kanë te bëjnë me lëshimin e certifikatave ISO per operatorin ekonomik andaj si rrjedhoj e kësaj ne raste kur autoriteti kontraktues dyshon ne mosplotësimin e kriterit përkatës sipas dosjes se tenderit duhet te jepen arsyet e mos plotësimit ne letrën standarde mbi tenderuesin e eliminuar mirëpo paraprakisht duhet te kërkojen sqarimet e nevojshme sipas dispozitave ligjore te lardekura.

Bazuar ne sqarimin e mësipërm konstatojm se pretendimi ankimor nr. 3 është pjesërisht i bazuar.

- Sa i përket pretendimit ankimor nr. 4. OE ankues është eliminuar nga Autoriteti Kontraktues sepse i mungon: Vendimi i menaxherit te projektit.

Sqarojm se OE ankues se bashku me ofertën e vet ka dorëzuar po ashtu Listen e personelit, e cila list përmban: Emrin/ mbiemrin, profesionin, eksperiencën dhe pozicionin; - Personel të angazhuar me kontrata ose parakontrata, shih listën ne vijim:



MBUROYA SH.P.K.
Adresa: William Walker
Kodi postar: 20000
Prizren, Republika e
Kosovës

LISTA E PUNETOREVE					
Nr	Emri	Mbiemri	Profesioni	Eksperienca	Pozicioni
1	Dr. Pajtim	Bytyqi	Ekolog	6 vite	Menaxher
2	Dr. Lebibë	Hashani	Epidemiologe	10 vite	Epidemiolog
3	Edon	Krasniqi	Punëtor i Certifikuar për Pest Control and Managment	3 vite	Punëtor i certifikuar për kontrollin dhe menaxhimin e demtuesve dhe kombinim te preparateve
4	Muhamed	Krasniqi	Punëtor i Certifikuar për Pest Control and Managment	3 vite	Punëtor i certifikuar për kontrollin dhe menaxhimin e demtuesve dhe kombinim te preparateve
5	Fehmi	Daka	Punëtor i Certifikuar për Pest Control and Managment	3 vite	Punëtor i certifikuar për kontrollin dhe menaxhimin e demtuesve dhe kombinim te preparateve
6	Enver	Hoti	Punëtor i Certifikuar për Pest Control and	3 vite	Punëtor i certifikuar për kontrollin dhe

Nga lista e lardekur rezulton se personi me nr renderi 1 është emëruar edhe menaxher per ketë aktivitet te prokurimit.

Sqarojmë se Autoriteti Kontraktues është dashur te kërkoj sqarimet përkatëse (informacione shitesë) sipas nenit 72 te LPP-së apo nenit 38 te Rregullores per Prokurim Publik ,pasi qe ne listën e stafit tani veq gjendet emri i personit qe është i cakuar menaxher.

Bazuar ne sqarimin e mësipërm konstatojm se pretendimi ankimor nr. 4 është pjesërisht i bazuar

Pretendimet ankimor nr 5 , 6 dhe 7 te cilat janë ne raport me ofertuesit e tjerë nuk i kemi trajtuar sepse AK-Komuna e Prizrenit edhe operatorët tjerë i ka eliminur nga aktiviteti i prokurimit si te pa përgjegjshëm dhe ka anuluar ne tërësi aktivitetin e prokurimit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 dhe 7 te LPP-se pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Bazuar ne përshkrimin e bërë me sipër, pretendimeve ankimore te operatorit ekonomik ankues sqarojm se AK-Komuna e Prizrenit ka anuluar ne tërësi aktivitetin e prokurimit ku tek te tre operatorët ekonomik ofertues kemi te bëjmë nder te tjera me arsyeshmeri te njëjtë te anulimit ku mungon “Licensa per veprimtarin sipas rregullores se OBSH-së” andaj rekomandojm Panelin Shqyrtues qe ankesa e operatorit ekonomik ankues te aprovohet pjesërisht e bazuar mirëpo te mbetet ne fuqi Vendimi i AK-së i datës 15.12.2025 mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit sepse oferta e operatorit ekonomik ankues nuk është ne harmoni te plotë me paragrafin 4 te nenit 59 te LPP-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues është pajtuar pjesërisht me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës dhe operatori ekonomik nuk është pajtuar me mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i caktuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, ku kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut

përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuar nga operatorëve ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorëve Ekonomik duhet të aprovohen si pjesërisht të bazuara, rrethimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi anulim Autoritetit Kontraktues – Komunës së Prizrenit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dezinsektimi dhe deratizimi i qytetit të Prizrenit dhe zonave periferike Kontrate Kornize 2 vjeçare” me numër të prokurimit 622-25-1796-2-2-1. 2. .

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- **OE - EKOLOGJIA SH.P.K., MBUROJA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: